



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-127
Prishtinë, më 11 nëntor 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 11 NËNTOR 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Eqrem Kryeziu, Nexhat Daci, Ibrahim Gashi dhe Naim Maloku, anëtarë të Kryesisë;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri dhe Sali Rexhepi.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 2 nëntor 2010,

2. Shqyrtimi i kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 2 nëntor 2010

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 2 nëntor 2010, u miratua pa vërejtje.

2. Njoftimi i Komisionit për Rregulloren e Kuvendit lidhur me statusin e Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Kryesia, pasi u njoftua me interpretimin e Komisionit për Rregulloren e Kuvendit lidhur me statusin e Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, mori këtë:

V E N D I M

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, sipas nenit 69 të Rregullores së Kuvendit, ka statusin e komision funksional.

3. Shqyrtimi i kërkesave të komisioneve parlamentare për kompensimin e grupeve punuese

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesat e komisioneve parlamentare, mori këtë:

V E N D I M

Kryesia nuk miratoi kërkesat e komisioneve parlamentare për kompensimin e grupeve punuese, me arsyetimin se puna e tyre, në kuadër të komisioneve parlamentare, konsiderohet punë e përhershme nga fushëveprimi i komisioneve parlamentare.

4. Çështja e pagave të deputetëve për muajin nëntor dhe dhjetor 2010

Kryesia, pasi shqyrtoi çështjen e pagave të deputetëve, mori këtë:

V E N D I M

Pas shpërndarjes së Kuvendit, duke filluar nga data 3 nëntor 2010, pagat e deputetëve të llogariten si paga bazë e deputetëve, me status pasiv, me përjashtim të anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit.

5. Çështja e zyrave të grupeve parlamentare dhe të kryetarëve të komisioneve

Kryesia, pasi shqyrtoi çështjen e zyrave të grupeve dhe të komisioneve parlamentare, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Zyrat e punës, në hapësirat e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, u lihen në shfrytëzim grupeve parlamentare dhe komisioneve parlamentare deri në fund të muajit nëntor 2010.

6. Statusi i stafit mbështetës politik për grupet parlamentare

Kryesia, pasi shqyrtoi çështjen e stafit mbështetës politik për grupet parlamentare, mori këtë:

V E N D I M

Statusi i stafit mbështetës politik të grupeve parlamentare vazhdohet deri në fund të muajit nëntor 2010.

7. Çështja e llap- topëve të deputetëve

Kryesia, pasi shqyrtoi çështjen e llap- topëve të deputetëve, mori këtë

V E N D I M

Llap –topët u lihen në shfrytëzim të përhershëm të gjithë ish-deputetëve dhe stafit politik.

8. Çështja e mbushjeve të telefonave për deputetë

Kryesia, pasi shqyrtoi çështjen e mbushjeve të telefonave për deputetë, mori këtë:

V E N D I M

Të gjithë deputetëve mbushjet e telefonave celular u jepen edhe për muajin nëntor 2010.

9. Kthimi i kartelave të votimit

Kryesia, pasi shqyrtoi çështjen kartelave të votimit, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet menjëherë nga ish-deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që t'i kthejnë kartelat e votimit në Shërbimin e deputetëve.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale